



# **Sfidat në trajtimin e krimeve të përgjithshme**

## **(Raporti i monitorimit të Divizioneve Penale gjatë vitit 2021)**



Autor: Mirvet Thaqi

Me kontribut të: Donjeta Ajvazi

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

## IKD

Rr. Rustem Statovci  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

Korrik, 2022  
Prishtinë, Republika e Kosovës

## Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive .....	4
2. Ngarkesa dhe efikasiteti i gjyqësorit me lëndë DP në vitin 2021 .....	5
3. Ngarkesa dhe efikasiteti i sistemit prokurorial me lëndë DP në vitin 2021.....	6
4. Trajtimi jo efikas i rasteve gjyqësore ndaj politikanëve .....	6
5. Dështimet e aktakuzave ndaj politikanëve.....	9
6. Aktakuzat ndaj të vdekurve .....	12
7. Aktakuzat e ushtruara për çështjet e gjykuara dhe ndaj personave të gabuar.....	13
8. Aktakuzat me të meta faktike dhe juridike .....	14
9. Gjykatësi “pishmanli” .....	15
10. Aplikimi "shabllon" i dënimit me kusht .....	17

## 1.Përmbledhja ekzekutive

Divizionet Penale (DP) të Gjykatave Themelore (GjTh) edhe gjatë vitit 2021 janë përballur me një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura, ku në fund të këtij viti të pakryera kanë mbetur edhe 31,314 lëndë DP. Një fenomen i tillë është ndër arsyet kryesore se pse lëndët në këto divizione zvarriten dhe nuk trajtohen brenda afateve ligjore. Gjykata Themelore në Prishtinë ka qenë gjykata më e ngarkuar me lëndë DP gjatë vitit 2021 (14,394), derisa më së paku lëndë të tilla ka pasur GjTh në Gjakovë (1,253). Gjykatësit më të ngarkuar me lëndë DP për vitin 2021 janë ata të GjTh në Prishtinë, me një mesatare prej 1,107 lëndë në punë për gjykatës, derisa më pak të ngarkuar kanë qenë gjykatësit e GjTh në Mitrovicë, me një mesatare prej 240,4 lëndë në punë për gjykatës.

Sa i përket Prokurorive Themelore, më e ngarkuar me lëndë DP gjatë vitit 2021 ka qenë PTH në Prishtinë (9,780), ndërsa më së paku lëndë DP ka pasur PTH në Ferizaj (2,120). PTH në Prishtinë prin edhe sa i përket ngarkesës mesatare me lëndë DP për një prokuror (407.5), ndërsa më pak të ngarkuar ishin prokurorët e PTH në Ferizaj me një mesatare prej 212 lëndëve për një prokuror.

Sa i përket trajtimit të rasteve gjyqësore ku janë të përfshirë politikanë, IKD ka identifikuar një zvarritje shumë më të madhe se sa zvarritjet që hasen në rastet e tjera ku janë të përfshirë qytetarë të rëndomtë. Një qasje e tillë e gjyqësorit krijon një perceptim negativ tek publiku për mungesë të guximit për trajtimin e rasteve të politikanëve nga ana e gjyqësorit, veçanërisht, nëse rastet e të njëjtëve parashkruhen. Krahas zvarritjeve, IKD ka identifikuar edhe të meta të tjera të shumta në trajtimin e rasteve të politikanëve. Në jo pak raste, këto të meta kanë bërë që rastet ndaj këtyre politikanëve mos të vendosen në mënyrë meritore. Kështu, këto raste kanë mbetur vetëm pretendime të prokurorisë dhe mbi to nuk është marrë fare vendim meritator nga gjykata.

Edhe gjatë vitit 2021 IKD ka evidentuar raste të shumta ku prokuroria ka ngritur aktakuza ndaj personave të vdekur. Aktakuza janë ushtruar edhe për rastet për të cilat gjykimi kishte përfunduar në formë të prerë si dhe ndaj personave të gabuar, apo për veprime që nuk përbëjnë vepra penale, çka përbën edhe mungesë të thellë të profesionalizmit të prokurorit të shtetit.

Po ashtu, IKD ka gjetur se një gjykatës i GjTh në Prishtinë i kishte rënë “pishman” lëshimit të urdhëresës për sjellje me detyrim ndaj një ministri, ndonëse këtë e kishte deklaruar publikisht në gjykatore dhe e kishte evidentuar në procesverbal. Për këto veprime, ndaj tij edhe është iniciuar procedurë disiplinore. Me këtë rast, i njëjti ka lejuar që çështja e lëshimit të këtij urdhërarresti të kalojë në heshtje, duke mos u informuar publiku nëse i njëjti është revokuar apo jo.

## 2. Ngarkesa dhe efikasiteti i gjyqësorit me lëndë DP në vitin 2021

Krimet e përgjithshme apo lëndët që gjykohen në Divizionet Penale të Departamenteve të Përgjithshme (DP) gjatë vitit 2021 kanë përbërë afro 18% të totalit të lëndëve që kanë qenë në punë në Gjykatat Themelore (50,181 lëndë).<sup>1</sup>

Në krahasim me vitin 2020, gjatë vitit 2021 kemi rritje të numrit të lëndëve DP që janë pranuar në punë nga gjykatat, për 17%. Rritje në krahasim me vitin 2020 ka edhe sa i përket zgjidhjes së lëndëve (për 15%), ndërsa është evidentuar rënie prej 6.22% e numrit të lëndëve të pazgjidhura.<sup>2</sup> Të pazgjidhura në fund të vitit 2021 kanë mbetur gjithsej 31,314 lëndë DP.

Gjykata më e ngarkuar me lëndë DP gjatë vitit të kaluar ka qenë GjTh në Prishtinë, me gjithsej 14,394 lëndë DP në punë, derisa më së paku lëndë të tilla ka pasur GjTh në Gjakovë, 1,253.<sup>3</sup>

Gjykata e Prishtinës prin edhe sa i përket ngarkesës me lëndë për një gjyqtar. Kjo pasi që gjatë vitit 2021, një gjykatës i kësaj gjykate ka qenë i ngarkuar mesatarisht me 1,107 lëndë DP. Derisa, sipas kësaj mesatareje, gjykatësit më pak të ngarkuar me lëndë të tilla janë gjykatësit e GjTh në Mitrovicë, me një mesatare prej 240,4 lëndë në punë.

Këto të dhëna tregojnë se gjykatësit në Gjykatën e Prishtinës janë gati pesëfish më shumë të ngarkuar me lëndë në krahasim me gjykatësit e një gjykate tjetër, në rastin konkret Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Për këtë arsye, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) duhet të ndërmarrë masa për shpërndarjen proporcionale të gjykatësve, duke aplikuar edhe transferimin e tyre, në mënyrë që të sigurohet procedimi efikas i lëndëve dhe që gjykatësit të kenë një numër të menaxhueshëm të lëndëve në punë.

Ndërsa, sa i përket procedimit të lëndëve DP në shkallë të dytë, vlen të theksohet se Gjykata e Apelit ka treguar efikasitet të lartë në zgjidhjen e lëndëve të kësaj natyre. Kjo pasi nga gjithsej 2,285 lëndë që i ka pasur në punë Apeli gjatë vitit 2021, ka arritur që deri në fund të kësaj periudhe raportuese të zgjidhë 1,771 lëndë DP apo 77.5%.

Reduktimi i lëndëve të vjetra, që barten vit pas viti, vazhdon të mbetet një ndër synimet kryesore të sistemit gjyqësor të Kosovës. Për këtë arsye, KGjK ka miratuar edhe Strategji të veçantë<sup>4</sup> dhe të njëjtën çështje e ka përfshirë edhe në Planin Strategjik për gjyqësorin e Kosovës 2020-2022.<sup>5</sup> Po ashtu, KGjK gjatë vitit të kaluar ka themeluar një grup punues për hartimin e një strategjie të re për reduktimin e lëndëve të vjetra. Megjithatë, është e domosdoshme që krahas hartimit të dokumenteve të tilla strategjike, Këshilli të mbikëqyrë në vazhdimësi përmbushjen e tyre në praktikë.

<sup>1</sup> “Raporti vjetor statistikor i Gjykatave – 2021”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Fq.3.

<sup>2</sup> **Shënim:** Në vitin 2020, gjykatat kanë pranuar gjithsej 15,182 lëndë të reja DP në punë, derisa në vitin 2021 17,772. Sa i përket lëndëve të zgjidhura, në vitin 2020 gjykatat kishin zgjidhur gjithsej 16,281, derisa në vitin 2021 kanë zgjidhur 18,867. Të pazgjidhura në fund të vitit 2020 kanë mbetur 33,393 lëndë DP, derisa në fund të vitit 2021 31,314 lëndë të tilla.

<sup>3</sup> Po aty. Fq. 8-34.

<sup>4</sup> KGjK. “Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra”. Gusht 2013.

<sup>5</sup> KGjK. “Plani Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës”. Shkurt 2020. Fq.5.

### 3. Ngarkesa dhe efikasiteti i sistemit prokurorial me lëndë DP në vitin 2021

Prokuroritë Themelore gjatë vitit 2021 kanë qenë të ngarkuara me gjithsej 25,962 lëndë DP. Referuar të dhënave statistikore të siguruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) del se prokuroria më e ngarkuar me lëndë të DP-ve gjatë vitit 2021 ka qenë PTh në Prishtinë me 9,780 lëndë në punë, derisa më së paku lëndë të tilla ka pasur PTh në Ferizaj, me 2,120 lëndë DP.

Prokuroria e Prishtinës prin edhe sa i përket ngarkesës mesatare me lëndë DP për një prokuror.<sup>6</sup> Një prokuror i kësaj prokurorie, mesatarisht, gjatë vitit të kaluar ka pasur në punë gjithsej 407,5 lëndë DP. Ndërsa, prokurorët më pak të ngarkuar me lëndë të tilla gjatë kësaj periudhe raportuese janë nga PTh në Ferizaj, me një mesatare prej 212 lëndëve në punë për një prokuror.

Ndërsa Prokuroria e Apelit, nga të dhënat e siguruar rezulton se ka pasur performancë prej 100% në zgjidhjen e lëndëve që i ka pasur në punë gjatë vitit 2021. Kjo pasi që nga 4,229 lëndë që kjo prokurori i ka pasur në punë, në fund të periudhës raportuese nuk ka mbetur asnjë lëndë e pazgjidhur. Megjithatë, aktiviteti i kësaj prokurorie dallon nga prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale dhe kjo për faktin se kjo prokurori nuk pranon kallëzime penale dhe nuk kryen as veprime hetimore sikurse instancat tjera prokuroriale, nuk përgatisin as ankesë ndaj vendimeve gjyqësore, por thjesht, pas analizimit të ankesave, Prokurorët e Apelit i drejtohen me parashtrësë Gjykatës së Apelit, me të cilën propozojnë aprovimin, hedhjen poshtë të ankesave apo ndryshimin e aktgjykimit. Kështu, kjo prokurori vazhdon të jetë një prokurori pasive, pa ndonjë rol në trajtimin e rasteve.<sup>7</sup>

### 4. Trajtimi jo efikas i rasteve gjyqësore ndaj politikanëve

Shumë politikanë që kanë probleme me ligjin janë ballafaquar me drejtësinë gjatë vitit 2021. Një fenomen negativ që i ka përcjellë këto procese gjyqësore<sup>8</sup> është trajtimi jo efikas i këtyre rasteve nga gjyqësori. Kjo manifestohet me faktin se gjykatat gjatë procedimit me raste të tilla nuk kanë respektuar afatet ligjore, duke i lënë këto lëndë të pagjykuara për vite me radhë.

I këtuillë është procesi gjyqësor ku Ministri i Punëve të Brendshme (MPB) Xhelal Sveçla dhe 12 të tjerë ngarkoheshin nga PTh në Prishtinë për pjesëmarrje në turmë që kryen vepra penale dhe huliganizëm.<sup>9</sup> Kjo aktakuzë ndaj tyre ishte ushtruar në mars të vitit 2014, ndërsa shqyrtimi i saj nga GjTh në Prishtinë kishte filluar në shkurt të vitit 2019, afro pesë (5) vite nga ngritja e aktit akuzues, duke shpërfillur afatet ligjore të cilat e obligojnë gjykatën që të caktojë seancën

<sup>6</sup> Përgjigje për IKD nga KPK. 7 qershor 2022.

<sup>7</sup> Bajraktari, L: “Prokuroria Pasive e Apelit”. Prishtinë. Shtator 2020. Fq. 18-21.

<sup>8</sup> **Shënim:** Të dhënat lidhur me proceset gjyqësore që janë përfshirë në këtë raport i referohen periudhës deri më 14 qershor 2022.

<sup>9</sup> “Ekskluzive: Ministri Xhelal Sveçla dhe 12 të tjerë ftohen në gjykatë si të akuzuar për veprime të dhunshme në protestën e vitit 2013, kundërshtonin marrëveshjen me Serbinë”. Betimi për Drejtësi. 10 gusht 2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-ministri-xhelal-svecla-dhe-12-te-tjere-ftohen-ne-gjyrate-si-te-akuzuar-per-veprime-te-dhunshme-ne-protesten-e-vitit-2013-kundershtonin-marreveshjen-me-serbine/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

fillestare brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës.<sup>10</sup> Ky rast akoma nuk ka arritur që të kalojë fazën e konfirmimit të aktakuzës. Për më tepër, gjykata nuk ka arritur që të bëjë një administrim efikas të drejtësisë, pasi që në këtë rast kanë dështuar të mbahen pesë (5) seanca gjyqësore, si pasojë e mungesës së të akuzuarve.<sup>11</sup>

Ndaj ministrit Sveçla rëndon edhe një akuzë tjetër e ushtruar më 29 korrik 2019 nga Prokuroria në Prishtinë, ku ai dhe tre deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) akuzohen për përdorim të armës dhe pengim të personit zyrtar. Edhe kjo aktakuzë nuk është proceduar nga gjykata brenda afatit ligjor, derisa tentativa e parë (e pasuksesshme) për nisjen e procesit gjyqësor në këtë rast ishte bërë tek pas 1,016 ditëve nga ngritja e aktakuzës.<sup>12</sup>

Deputeti nga radhët e LVV-së, Salih Zyba, për më shumë se gjashtë (6) vite po përballet me akuzën për sulm ndaj personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare. Ndonëse aktakuza ndaj tij ishte ushtruar më 29 janar 2016, seanca fillestare ndaj tij ishte mbajtur vetëm më 10 qershor 2021, apo 1,959 ditë nga ngritja e aktakuzës. Ndonëse aktakuza në këtë çështje penale është konfirmuar në korrik të vitit 2021 nga gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit,<sup>13</sup> gjykata akoma nuk ka filluar shqyrtimin gjyqësor në këtë rast.

Me aktakuzë për dy vepra penale po ngarkohet edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës Glauk Konjufca. Aktakuza ndaj tij është ngritur nga prokuroria më 3 shkurt 2017, mirëpo, gjykata kishte filluar me trajtimin e kësaj lënde në prill të vitit 2022, pas më shumë se pesë (5) viteve nga ngritja e aktit akuzues.<sup>14</sup>

Neglizhencë ka shfaqur GjTh në Prishtinë edhe me rastin e trajtimit të aktakuzës së ushtruar ndaj deputetit Valon Ramadani. Ai akuzohet se ka kryer dy vepra penale, atë të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm dhe pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Aktakuza ndaj tij ishte ushtruar më 30 korrik 2019, derisa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 13 korrik 2021, pra gati dy (2) vite nga ngritja e aktakuzës. Në tetor 2021 kjo aktakuzë ishte

---

<sup>10</sup> Kodi nr. 04/L-123 i procedurës penale. Neni 242.4 “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”.

<sup>11</sup> “Sërish dështon të nis gjykimi ndaj ministrit Sveçla dhe 12 të tjerëve, të akuzuar për veprime të dhunshme në protestën e 2013-ës”. Betimi për Drejtësi. 6 Qershor 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-deshton-te-nis-gjykimi-ndaj-ministrit-svecla-dhe-12-te-tjereve-te-akuzuar-per-veprime-te-dhunshme-ne-protesten-e-2013-es/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

<sup>12</sup> “Mungon ministri Sveçla dhe deputetja Pacolli-Dalipi, dështon të nis gjykimi për hedhjen e gazit lotsjellës më 2018 në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 10 maj 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-ministri-svecla-dhe-deputetja-pacolli-dalipi-deshton-te-nis-gjykimi-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-me-2018-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

<sup>13</sup> “Pas më shumë se 6 muajsh kur Apeli ka konfirmuar aktakuzën ndaj deputetit Valon Ramadani, seanca e radhës ende nuk është caktuar”. Betimi për Drejtësi. 4 maj 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-me-shume-se-6-muajsh-kur-apeli-ka-konfirmuar-aktakuzen-ndaj-deputetit-valon-ramadani-seanca-e-radhes-ende-nuk-eshte-caktuar/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

<sup>14</sup> “Ekskluzive: Glauk Konjufca do të përballet me aktakuzën e ngritur më 2017 për gaz lotsjellës dhe pengim të personit zyrtar”. Betimi për Drejtësi. 7 prill 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-glauk-konjufca-do-te-perballet-me-aktakuzen-e-ngritur-me-2017-per-gaz-lotsjelles-dhe-pengim-te-personit-zyrtar/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).; “Glauk Konjufca deklarohet i pafajshëm për hedhje të gazit lotsjellës dhe pengim të personit zyrtar më 2016 në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 19 prill 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/glauk-konjufca-deklarohet-i-pafajshem-per-hedhje-te-gazit-lotsjelles-dhe-pengim-te-personit-zyrtar-me-2016-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 09.06.2022).

konfirmuar edhe nga Apeli,<sup>15</sup> mirëpo që nga ajo kohë gjykata nuk e ka filluar akoma shqyrtimin kryesor në këtë çështje penale, me arsyetimin se janë duke proceduar lëndë të tjera më me prioritet.<sup>16</sup>

Në kundërshtim me afatet procedurale dhe në mënyrë jo efikase janë proceduar edhe rastet gjyqësore ndaj ish-kryetarit të Komunës së Prizrenit Mytaher Haskuka dhe katër ish-deputetëve<sup>17</sup>, ndaj deputetit të AAK-së Pal Lekaj<sup>18</sup>, atij të PDK-së Xhavit Haliti<sup>19</sup> dhe kryetarit të PSD-së Dardan Molliqaj<sup>20</sup>.

Haskuka dhe ish-deputetët Enver Hoti, Shqipe Pantina, Teuta Haxhiu dhe Rexhep Selimi, sipas aktakuzës së ushtruar më 20 prill 2016 akuzohen për dy vepra penale, atë të përdorimit të armës dhe pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Pas dy tentativave të dështuara<sup>21</sup>, GjTh në Prishtinë kishte arritur që të mbajë shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale më 11 shkurt 2022, kur kishin kaluar 2,123 ditë nga ngritja e aktit akuzues, në shpërfillje të plotë me afatet procedurale të parapara me legjislacionin në fuqi. Ndaj Selimit, gjykata ka bërë veçimin e procedurës, meqë ky i fundit po përballet me drejtësinë në Gjykatën Speciale në Hagë.

Që nga qershori i vitit 2017 deputeti nga AAK-ja Pal Lekaj ka të ngritur aktakuzë në drejtim të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, si pasojë e hedhjes së gazit lotsjellës në kuvend. Edhe ky rast penal nuk ka pasur trajtim brenda afateve të arsyeshme kohore nga ana e GjTh në Prishtinë. Kjo pasi që kjo aktakuzë akoma nuk ka arritur që të lexohet për herë të parë, e as që të kaloj filtrat gjyqësorë, ndonëse kanë kaluar afro pesë (5) vite nga ngritja e saj.

Deputeti nga radhët e PDK-së Xhavit Haliti është politikani tjetër i cili ka probleme me ligjin dhe që rasti ndaj tij akoma nuk ka marrë një epilog. Në maj të vitit 2019, prokuroria kishte

---

<sup>15</sup> “Pas më shumë se 6 muajsh kur Apeli ka konfirmuar aktakuzën ndaj deputetit Valon Ramadanit, seanca e radhës ende nuk është caktuar”. Betimi për Drejtësi. 4 maj 2022. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-me-shume-se-6-muajsh-kur-apeli-ka-konfirmuar-aktakuzen-ndaj-deputetit-valon-ramadanit-seanca-e-radhes-ende-nuk-eshte-caktuar/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

<sup>16</sup> Përgjigje për IKD nga GjTh në Prishtinë. 27 maj 2022.

<sup>17</sup> “Në mungesë të Mytaher Haskukës dhe Rexhep Selimit, shtyhet sërish gjykimi për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 24 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-mungese-te-mytaher-haskukes-dhe-rexhep-selimit-shtyhet-serish-gjykimi-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

<sup>18</sup> “Ekskluzive: Pal Lekaj do të përballet me aktakuzën e ngritur më 2017 për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 7 prill 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-pal-lekaj-do-te-perballet-me-aktakuzen-e-ngritur-me-2016-per-hedhje-te-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 09.06.2022).

<sup>19</sup> “Xhavit Haliti në udhëtim jashtë vendit, dështon të mbahet shqyrtimi gjyqësor për sulm ndaj Arben Gashit”. Betimi për Drejtësi. 9 qershor 2022 (<https://betimiperdrejtesi.com/xhavit-haliti-ne-udhetim-jashte-vendit-deshton-te-mbahet-shqyrtimi-gjyqesor-per-sulm-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur së fundi më 09.06.2022).

<sup>20</sup> “Policia nuk zbaton urdhrin e gjykatës për të sjellë Dardan Molliqajn në seancë, përfaqësuesja e Haki Abazit kërkon paraburgimin e tij”. Betimi për Drejtësi. 1 qershor 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-dardan-molliqaj-deshton-te-nis-gjykimi-per-perleshjes-fizike-mes-tij-dhe-haki-abazit/>). (Qasur për herë të fundit më 09.06.2022).

<sup>21</sup> “Në mungesë të Mytaher Haskukës dhe Rexhep Selimit, shtyhet sërish gjykimi për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 24 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-mungese-te-mytaher-haskukes-dhe-rexhep-selimit-shtyhet-serish-gjykimi-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 09.06.2022).



ushtruar aktakuzë ndaj Halitit për veprën penale sulm.<sup>22</sup> Fillimisht kjo lëndë kishte pasur trajtim më të shpejtë nga gjykata, e cila më 14 tetor 2019 kishte aprovuar kërkesën e prokurorisë, dhe pas shqyrtimit paraprak të çështjes, kishte shqiptuar urdhër ndëshkimor ndaj Haliti, duke e dënuar me gjobë prej 1,250 euro. Mirëpo, i pakënaqur me këtë vendim, Haliti kishte ushtruar kundërshtim brenda afatit ligjor. Pas këtij veprimi, gjykata ka qenë e obliguar që të procedoj me shqyrtimin gjyqësor të këtij rasti, por që ky veprim është ndërmarrë pasi kishin kaluar më shumë se dy vite e shtatë muaj.<sup>23</sup>

Me zvarritje dhe mos respektim të afateve ligjore gjykata ka trajtuar edhe rastin e përlshjes fizike mes Dardan Molliqajt dhe deputetit të LVV-së Haki Abazi. Sipas aktakuzës së ushtruar, më 18 shkurt 2020 Molliqaj akuzohej për veprën penale sulmi. Seanca fillestare në këtë rast ishte tentuar të mbahet më 1 qershor 2022, pas më shumë se dy (2) viteve nga ngritja e aktakuzës.<sup>24</sup>

Sa i përket zvarritjes së lëndëve gjyqësore në divizionet penale, fillimisht, pothuajse në të gjitha rastet të cilat trajtohen në kuadër të këtij divizioni, IKD ka identifikuar mos trajtim të rasteve brenda afateve të përcaktuara me ligj. Por, në rastet e politikanëve si më lart, IKD ka identifikuar një zvarritje shumë më të madhe sesa zvarritjet në rastet e tjera ku janë të përfshirë qytetarët e tjerë. Rastet si më lart nuk kanë ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë e cila do ta arsyetonte trajtimin më të ngadalshëm të këtyre rasteve në raport me rastet e tjera.

Kështu, në parim, kjo zvarritje, përtej zvarritjes së zakonshme së rasteve DP, nuk duket të jenë karakteristikë për të gjitha rastet të cilat trajtohen në DP, por karakteristikë e rasteve të politikanëve të cilat trajtohen në këto departamente. Kjo qasje e gjyqësorit krijon një percepton negativ tek publiku për mungesë të guximit të trajtimit të rasteve të politikanëve nga ana e gjykatave, veçanërisht, nëse rastet e të njëjtëve parashkruhen.

## 5. Dështimet e aktakuzave ndaj politikanëve

Krahas zvarritjeve të proceseve gjyqësore, IKD ka identifikuar edhe të meta të tjera të shumta në trajtimin e rasteve të politikanëve. Në jo pak raste, këto të meta kanë bërë që rastet ndaj këtyre politikanëve të mos mund të vendosen në mënyrë meritore nga gjykatat. Kështu, këto raste kanë mbetur vetëm akuza apo pretendime të prokurorisë dhe mbi to nuk është marrë fare vendim meritor nga gjykata.

---

<sup>22</sup> “Ekskluzive: Aktakuzë ndaj Xhavit Halitit dhe Gani Dreshajt për sulmin dhe kanosjen ndaj Arben Gashit”. Betimi për Drejtësi. 16 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-aktakuze-ndaj-xhavit-halilit-dhe-gani-dreshajt-per-sulmin-dhe-kanosjen-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 09.06.2022).

<sup>23</sup> “Xhavit Haliti në udhëtim jashtë vendit, dështon të mbahet shqyrtimi gjyqësor për sulm ndaj Arben Gashit”. Betimi për Drejtësi. 9 qershor 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/xhavit-haliti-ne-udhetim-jashte-vendit-deshton-te-mbahet-shqyrtimi-gjyqesor-per-sulm-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 10.06.2022).

<sup>24</sup> “Policia nuk zbaton urdhrin e gjykatës për të sjellë Dardan Molliqajn në seancë, përfaqësuesja e Haki Abazit kërkon paraburgimin e tij”. Betimi për Drejtësi. 1 qershor 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-dardan-molliqaj-deshton-te-nis-gjykimi-per-perleshjes-fizike-mes-tij-dhe-haki-abazit/>). (Qasur për herë të fundit më 10.06.2022).

Kështu, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale ishte pushuar procedura penale ndaj ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe shtatë të akuzuarve të tjerë.<sup>25</sup> Aktakuza e ushtruar më 15 mars 2018 i ngarkonte të njëjtit me veprën penale pengimi i personit zyrtar të kryer në bashkëkryerje. Kjo aktakuzë ishte kthyer dy herë në plotësim nga ana e gjykatës, me pretendimin se kishte të meta.<sup>26</sup>

Prokuroria më 15 mars 2021 kishte bërë precizimin e dispozitivit të aktakuzës vetëm përkitazi me personat, e jo sa i përket emërtimit ligjor, ashtu siç kërkonte gjykata. Kjo kishte ndikuar që gjykata për herë të dytë ta kthejë në plotësim këtë aktakuzë. Megjithatë, në aktin përcjellës të datës 23 shtator 2021, prokuroria theksonte se mbetej pranë aktakuzës së ushtruar, duke arsyetuar se e njëjta përmbante të gjitha rrethanat e nevojshme që kanë përcaktuar me saktësi veprën penale dhe emërtimin ligjor të veprës penale.<sup>27</sup> Në rrethana të tilla, gjykata kishte caktuar shqyrtimin fillestar për datën 21 tetor 2021, i cili kishte dështuar të mbahej.<sup>28</sup>

Në rastin konkret, prokuroria kishte vepruar në kundërshtim me nenin 442.4 të KPP-së<sup>29</sup>, duke mos plotësuar dhe korrigjuar aktin akuzues konform kërkesave të gjykatës. Kjo dispozitë e obligon gjykatën që të hedhë poshtë këtë aktakuzë në rast të mos veprimit, mirëpo kështu nuk kishte vepruar gjykata, e cila kishte proceduar tutje me gjykim. Kështu, krahas prokurorisë, ligjin në këtë rast nuk e kishte zbatuar drejt as gjykata.

Për më tepër, aktakuza në fjalë ka pasur të meta lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, i cili nuk ka qenë në përputhje me gjendjen faktike të përshkruar në aktin akuzues. Marrë parasysh faktin se në rastin konkret, si palë të dëmtuara paraqiten zyrtarët policorë, PTh në Prishtinë është dashur që këto veprime që u janë mveshur të akuzuarve t'i kualifikojë me paragrafin 5 të nenit 409 të Kodit nr. 04/1-082 Penal të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet qartë se *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor..”*. Një veprim i tillë i prokurorisë, do të pamundësonte që në këtë çështje penale të arrinte parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi që par.5 i kësaj dispozite, ka përcaktuar dënim më të rëndë, prej 1-5 vjet burgim dhe për këtë vepër penale, ligji ka paraparë edhe afat më të gjatë të parashkrimit.<sup>30</sup>

---

<sup>25</sup> *“Për shkak të parashkrimit, gjykata hedh poshtë aktakuzën ndaj ish-kryeministrit Haradinaj dhe të tjerëve”*. Betimi për Drejtësi. 30 mars 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-shkak-te-parashkrimit-gjykata-hedh-poshte-aktakuzen-ndaj-ish-kryeministrit-haradinaj-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 10.06.2022).

<sup>26</sup> Përgjigje për IKD nga GjTh në Prishtinë. 29 prill 2022.

<sup>27</sup> Akt Përcjellës i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, i datës 23 shtator 2021.

<sup>28</sup> *“Dështon gjykimi ndaj ish-kryeministrit Haradinaj dhe shtatë ish-deputetëve, ngarkohen se penguan policët gjatë arrestimit të Kurtit”*. Betimi për Drejtësi. 21 tetor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-gjykimi-ndaj-ish-kryeministrit-haradinaj-dhe-shtate-ish-deputeteve-ngarkohen-se-penguan-policet-gjate-arrestimit-te-kurtit/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022).

<sup>29</sup> KPPK. Neni 442.4 *“Nëse me këtë Kod nuk është paraparë ndryshe, gjykata thërret paraqitësin e parashtrësës së pakuptueshme ose që nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjojë apo ta plotësojë parashtrësën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjykata e hudh poshtë parashtrësën”*.

<sup>30</sup> Kodi nr. 04/1-082 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 106.1.1.5 *“Përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme: ...“pesë (5) vjet nga*

Edhe ndaj deputetit Salih Zyba është pushuar procedura penale për shkak të parashkrimit.<sup>31</sup> Aktakuza në këtë rast ishte ushtruar më 23 janar 2017. Pas gati tre viteve nga ushtrimi i aktit akuzues, GjTh në Prishtinë e kishte deleguar këtë lëndë për vendosje në Gjykatën e Drenasit, sipas kompetencës territoriale. Vlerësimi i kompetencës mbi çështjen është ndër veprimet e para që gjykata ndërmerr pas ushtrimit të aktakuzës dhe atë duke vepruar sipas detyrës zyrtare.<sup>32</sup> Andaj, kjo mënyrë e të vepruarit, ku është vonuar vendosja lidhur me kompetencën për tri vite, ka ndikuar që ky rast paarsyeshëm të zvarritet. Kjo lëndë në Gjykatën e Drenasit është pranuar më 11 dhjetor 2019. Kjo gjykatë deri në nxjerrjen e vendimit për pushim të procedurës për tre nga të akuzuarit, kishte provuar pesë herë që të procedojë me këtë lëndë, por pa sukses si pasojë e mungesës së të akuzuarve, çka paraqet një administrim joefikas të drejtësisë. Po ashtu, edhe vendimi për hedhje të aktakuzës ndaj Zybës dhe dy të tjerëve ishte marrë më 4 mars 2022, ndonëse parashkrimi absolut i ndjekjes penale kishte arritur më 27 janar 2021. Gjykata është e obliguar që sipas detyrës zyrtare të vlerësojë nëse ekzistojnë pengesa ligjore për të proceduar me çështjet që shtrohen para saj dhe të ndërmerr veprime konform ligjit, përdërisa në rastin konkret kjo gjykatë kishte vazhduar që të caktoj seanca gjyqësore edhe pas këtij afati, ndonëse për disa nga të akuzuarit e përfshirë në këtë rast kishte arritur parashkrimi.

Prokurori i Shtetit jo rrallë herë është tërhequr nga aktet e veta akuzuese edhe para se të njëjtat të shqyrtohen në gjykatë. I tillë është edhe rasti i tërheqjes nga ndjekja penale ndaj nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci. Ajo akuzohej nga PTh në Prishtinë për pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas aktakuzës së 17 nëntorit 2017. Kjo aktakuzë nuk ka arritur që të shqyrtohet në gjykatë, pasi që prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale.<sup>33</sup>

Kjo qasje e Prokurorit të Shtetit që të ushtrojë aktakuza ndaj figurave politike, të cilat më vonë tërhiqen pas analizimit të shkresave të lëndës, paraqet jo profesionalizëm të këtij institucioni, e cila qasje po ashtu mund të krijojë përcipion për trajtimin selektiv dhe persekutues. Betimi për Drejtësi edhe më parë kishte raportuar për një rast të kësaj natyre, kur aktakuza e ushtruar ndaj Liburn Aliut ishte tërhequr akoma pa u shqyrtuar në gjykatë.<sup>34</sup>

---

*kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim*". Neni 107.8 "Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit".

<sup>31</sup> "Hudhet aktakuza ndaj deputetit Zyba dhe dy të tjerëve për pjesëmarrje në protestat e vitit 2015". Betimi për Drejtësi. 21 maj 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-ndaj-deputetit-zyba-dhe-dy-te-tjereve-per-pjesemarrje-ne-protestat-e-vitit-2015/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022).

<sup>32</sup> KPPK. Neni 242.3 "Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përbën aktakuzën".

<sup>33</sup> "Hudhet aktakuza ndaj Nënkyetares së Parlamentit, ngarkohej se pengoi punën e një polici më 2015". Betimi për Drejtësi. 17 gusht 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-ndaj-nenkryetares-se-parlamentit-ngarkohej-se-pengoi-punen-e-nje-polici-me-2015/>). (Qasur për herë të fundit më 14.06.2022).

<sup>34</sup> "Prokuroria tërhiqet nga aktakuza, pushohet procedura penale ndaj ish-deputetit Liburn Aliu". Betimi për Drejtësi. 15 tetor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-aktakuza-pushohet-procedura-penale-ndaj-ish-deputetit-liburn-aliu/>). (Qasur për herë të fundit më 14.06.2022).

## 6. Aktakuzat ndaj të vdekurve

Sikurse edhe në vitet e kaluara, Prokurori i Shtetit ka vazhduar të ngrisë aktakuza ndaj personave të vdekur. Mos zhvillimi i hetimeve ka sjellë në situatat që Prokurori i Shtetit të ushtrojë aktakuza të tilla. Këto aktakuza, përveç se të paqëndrueshme në aspektin juridik, e kanë ngarkuar pa nevojë gjyqësorin me lëndë.

Monitorimi sistematik i punës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial ka vënë në dukje një sërë aktesh akuzuese të kësaj natyre. I tillë është rasti i ngritjes së aktit akuzues ndaj personit që kishte vdekur 8 vite para ushtrimit të aktakuzës,<sup>35</sup> apo ngritja e aktakuzës ndaj dy personave të vdekur.<sup>36</sup> Po ashtu, një person ishte akuzuar nga prokuroria një vit pas vdekjes së tij,<sup>37</sup> e në një rast tjetër si i akuzuar kishte përfunduar edhe personi i cili kishte vdekur që në vitin 1992<sup>38</sup>, e për armëmbajtje pa leje ishte akuzuar edhe një person gati një vit pas vdekjes.<sup>39</sup> IKD ka identifikuar edhe një sërë vendimesh gjyqësore të nxjerra nga gjykatat për pushim të procedurës penale dhe hedhjes së aktakuzave të ushtruara ndaj personave të vdekur.<sup>40</sup>

Në rastet e tilla Prokurori i Shtetit ka shfrytëzuar dispozitën ligjore e cila i jep mundësinë që të ngritë aktakuza të drejtpërdrejta. Por, kjo përbën një përjashtim dhe nuk përbën rregull standarde e cila duhet aplikuar në të gjitha rastet kur kemi vepra penale që mund të dënohen deri në tri vite burgim, ngase edhe për vepra të tilla parashihet iniciimi i procedurës hetimore, mbledhja e provave të mjaftueshme që e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale, e pastaj të ushtrohet akti akuzues në gjykatë.<sup>41</sup>

Për më tepër, prokuroria në të shumtën e këtyre rasteve ka shfrytëzuar të dhënat nga kallëzimet penale, të cilët kanë qenë me të meta. Kallëzimet penale duhet që krahas të tjerave, të identifikojnë mirë edhe të pandehurin. Në këtë drejtim, Kodi i Procedurës Penale ka vënë

---

<sup>35</sup> “Tre ditë më parë Prokuroria në Prishtinë ka ngritur aktakuzë ndaj personit që ka vdekur para 8 vitesh, gjykata e pushon procedurën penale”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/tre-dite-me-pare-prokuroria-ne-prishtine-ka-ngritur-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-para-8-vitesh-gjykata-e-pushon-proceduren-penale/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>36</sup> “Prokuroria ngritë dy aktakuza për dy persona të vdekur, gjykata pushon procedurën ndaj tyre”. Betimi për Drejtësi. 20 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrite-dy-aktakuza-per-dy-persona-te-vdekur-gjykata-pushon-proceduren-ndaj-tyre/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>37</sup> “Një vit pasi vdiq iu ngrit aktakuza, gjykata e hudhë poshtë”. Betimi për Drejtësi. 15 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-vit-pasi-vdiq-iu-ngrit-aktakuza-gjykata-e-hudhe-poshte/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>38</sup> “Prokuroria e Gjilanit ngritë aktakuzë ndaj personit që ka vdekur në vitin 1992, gjykata pushon procedurën”. Betimi për Drejtësi. 16 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-e-gjilanit-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-ne-vitin-1992-gjykata-pushon-proceduren/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>39</sup> “Gati një vit pas vdekjes i ngritet aktakuzë për armëmbajtje pa leje, gjykata e hudhë poshtë”. Betimi për Drejtësi. 23 janar 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gati-nje-vit-pas-vdekjes-i-ngritet-aktakuze-per-armembajtje-pa-leje-gjykata-e-hudhe-poshte/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>40</sup> Aktvendimet P.nr.26/19; P.nr. 255/2020; P.nr. 38/2020; P.nr.1139/17; P.nr.127/17; P.nr.307/2018; P.nr.220/20; P.nr.218/21; P.nr.100/21; P.nr.298/19; P.nr.170/18.

<sup>41</sup> KPPK. Neni 240.1 “Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit”.

detyrimin për të gjithë akterët që marrin pjesë në procedurë penale që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet, të cilat janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm.<sup>42</sup>

Verifikimi i statusit jetësor të të akuzuarve/pandehurve nga ana e prokurorive, sipas KPK-së, bëhet “përmes sistemit elektronik të Regjistrimit Civil (ARC) për të gjithë palët që kanë numër personal të Republikës së Kosovës, ngase SMIL-i është i ndërlidhur me këtë sistem dhe njëra nga të dhënat që kopjohet nga ARC-ja është edhe statusi jetësor”.<sup>43</sup> Andaj, meqë një sistem i tillë është në zbatim e sipër, ushtrimi i aktakuzave të tilla dëshmon për një mungesë profesionalizmi të prokurorëve që veprojnë në kuadër të sistemit prokurorial. Për më tepër, kjo përbën edhe shkelje të detyrave dhe kompetencave të prokurorit të shtetit, të cilët duhet të zbatojnë standardet më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare.<sup>44</sup>

## 7. Aktakuzat e ushtruara për çështjet e gjykuara dhe ndaj personave të gabuar

Gjatë monitorimit, IKD ka identifikuar raste kur Prokurori i Shtetit kishte akuzuar persona të gabuar, kishte ushtruar dy aktakuza për çështjen e njëjtë, apo edhe kishte ushtruar aktakuza për raste të cilat veçse kishin përfunduar me vendime të formës së prerë (çështje të gjykuara).

Gjatë vitit të kaluar, në bankën e të akuzuarve ishte ulur një person për vjedhje rryme, mirëpo për të njëjtin më pas prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale, pasi kishte konstatuar se e kishte akuzuar gabimisht.<sup>45</sup> Për shkak të një gabimi teknik nën aktakuzë kishte përfunduar edhe një person tjetër<sup>46</sup>, e ndaj një personi ish-in ushtruar dy aktakuza për të njëjtin rast.<sup>47</sup> Në një rast tjetër, një 83 vjeçar ishte akuzuar për keqpërdorim të energjisë elektrike, mirëpo më pas prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale, me pretekstin se ai nuk ka pasur mundësi fizike të kryejë veprën që i ngarkohej.<sup>48</sup> Po ashtu, PTh në Gjilan kishte akuzuar një person, por që më pas ishte tërhequr nga ndjekja, me pretendimin se bëhet fjalë për një të akuzuar tjetër.<sup>49</sup> Një

<sup>42</sup> Rrezniqi, A: “Prokurorët në Kosovës ngrisin aktakuza ndaj të vdekurve”. Prishtinë. Nëntor 2019. Fq.5.

<sup>43</sup> Përgjigje për IKD nga KPK. 14.06.2022.

<sup>44</sup> Ligji Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, neni 7.1.1.2.

<sup>45</sup> “Shpallet i pafajshëm pasi prokuroria e pranoi se dikush tjetër ka vjedhur rrymë në vlerë prej 94 euro”. Betimi për Drejtësi. 8 korrik 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-pasi-prokuroria-e-pranon-se-dikush-tjeter-ka-vjedhur-rryme-ne-vlere-prej-94-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>46</sup> “Shpallet aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit për vjedhje pylli i cili ishte akuzuar gabimisht”. Betimi për Drejtësi. 19 janar 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-aktgjykim-refuzues-ndaj-te-akuzuarit-per-vjedhje-pylli-i-cili-ishte-akuzuar-gabimisht/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>47</sup> “Prokurori heq dorë nga ndjekja penale, pasi konstatohet se për të njëjtin rast ish-in ngritur dy aktakuza”. Betimi për Drejtësi. 18 nëntor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-pasi-konstatohet-se-per-te-njejtin-rast-ishin-ngritur-dy-aktakuza/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>48</sup> “Prokurori heq dorë nga ndjekja penale ndaj 83 vjeçarit të akuzuar për vjedhje rryme, thotë se ai nuk ka mundësi fizike ta kryej atë veprim”. Betimi për Drejtësi. 7 qershor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-ndaj-83-vjecarit-te-akuzuar-per-vjedhje-rryme-thote-se-ai-nuk-ka-mundesi-fizike-ta-kryej-ate-veprim/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>49</sup> “Prokurorja tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit për vjedhje të rrymës”. Betimi për Drejtësi. 7 korrik 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-terhiqet-nga-ndjekja-penale-ndaj-te-akuzuarit-per-vjedhje-te-rrymes/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

akuzë ishte refuzuar me arsyetimin se për të njëjtën çështje i akuzuari ishte dënua më parë.<sup>50</sup> Me arsyetimin se çështja ishte e gjykuar, gjykata kishte pushuar edhe procedurën penale ndaj një personi i cili ishte liruar me vendim të formës së prerë.<sup>51</sup> Për rastin e njëjtë, ndaj tre personave PTh në Mitrovicë kishte ushtruar dy aktakuza<sup>52</sup>, e në një rast tjetër, PTh në Prishtinë ishte tërhequr nga ndjekja penale pas konstatimit se për të njëjtin rast ishin ngritur dy aktakuza.<sup>53</sup>

Një praktikë e tillë shpërfaqë mungesë profesionalizmi të prokurorëve si dhe dëshmon se të njëjtit nuk kanë zbatuar standardet minimale të kujdesit gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar. Kështu, në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të detyrave dhe kompetencave të prokurorëve<sup>54</sup> dhe shkelje disiplinore.<sup>55</sup> Ndërsa, rastet kur brenda një prokurorie ngritën dy akte akuzuese për të njëjtin rast tregojnë se ka një mungesë të theksuar të administrimit adekuat të punës brenda një prokurorie të caktuar. Ngritjes së akteve akuzuese duhet t'i paraprijë një procedurë hetimore, e realizuar në mënyrë profesionale dhe të drejtë. Duhet pasur parasysh se ngritja e aktakuzës nuk është vetëm një akt i thjeshtë formal por se konsiston në kufizimin e disa lirive dhe të drejtave të njeriut.

## 8. Aktakuzat me të meta faktike dhe juridike

Gjatë monitorimit, IKD ka identifikuar edhe raste kur Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuza për çështje të cilat qartazi nuk përbëjnë vepra penale. Ngritja e aktakuzave të kësaj natyre shfaqë mungesë të profesionalizmit të Prokurorit të Shtetit, krijon precedentë të rrezikshëm dhe cenon sigurinë juridike të qytetarëve.

I këtillë është rasti ku dy gazetarë, për një shkrim të publikuar në media kundër biznesmenit Blerim Devolli, ishin akuzuar nga PTh në Prishtinë për lajmërim të rremë. Ata akuzoheshin se në një portal, kishin publikuar informacione të pavërteta ndaj Devollit, se kinse ky i fundit posedon pasaportë të falsifikuar të Malit të Zi.<sup>56</sup> Megjithatë, gjatë këtij viti, pas raportimit të

---

<sup>50</sup> “Refuzohet aktakuza ndaj të akuzuarit që për plug të traktorit e kishte sulmuar të dëmtuarin”. Betimi për Drejtësi. 21 prill 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohet-aktakuza-ndaj-te-akuzuarit-qe-per-plug-te-traktorit-e-kishte-sulmuar-te-demtuarin/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>51</sup> “U akuzua më 2012 për rastin që ishte liruar me vendim të formës së prerë, gjykata vitin e kaluar pushoi procedurën ndaj tij”. Betimi për Drejtësi. 6 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/u-akuzua-me-2012-per-rastin-qe-ishte-liruar-me-vendim-te-formes-se-prere-gjykata-vitin-e-kaluar-pushoi-proceduren-ndaj-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>52</sup> “Prokuroria Themelore në Mitrovicë ngritë dy aktakuza ndaj tre personave për rastin e njëjtë”. Betimi për Drejtësi. 6 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrite-dy-aktakuza-ndaj-tre-personave-per-rastin-e-njejte-gjykata-e-hudhe-njeren-prej-tyre/>). (Qasur së fundi më 15.06.2022).

<sup>53</sup> “Prokurori heq dorë nga ndjekja penale, pasi konstatohet se për të njëjtin rast ishin ngritur dy aktakuza”. Betimi për Drejtësi. 18 nëntor 2021 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-pasi-konstatohet-se-per-te-njejtin-rast-ishin-ngritur-dy-aktakuza/>). (Qasur së fundi më 15.06.2022).

<sup>54</sup> Ligji Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, neni 7.1.1.2.

<sup>55</sup> Ligji Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 6.1.1.3.

<sup>56</sup> “Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për “lajmërim apo kallëzim i rremë”, sipas prokurorisë ata veprat i kanë kryer përmes publikimit në portal”. Betimi për Drejtësi. 4 prill 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shkelzen-dhe-valdete-dakaj-deklarohen-te-pafajshem-per-publikimin-e-informatave-te-paverteta-permes-portalit-te-tyre-infokusi/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

këtij rasti për publikun, prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale me pretekstin se nuk ka elemente të veprës penale, pas më shumë se katër viteve nga ushtrimi i kësaj aktakuze.<sup>57</sup>

Prokurori i Shtetit me rastin e ushtrimit të kësaj aktakuze ka treguar mungesë të njohurive elementare të legjislationit në fuqi. Kjo ngase, publikimi i informacionit të rremë nuk kategorizohet si vepër penale, por se çështje të tilla trajtohen me një ligj të veçantë, Ligjit nr. 02/L-65 civil kundër shpifjes dhe fyerjes dhe realizimi i të drejtave sipas këtij ligji bëhet në procedurë civile. Prokuroria në rastin konkret kishte vlerësuar se publikimi i lajmit të rremë ishte vepër penale, ndonëse vet figura e veprës penale të lajmërimit të rremë nuk gjen asnjë përputhje me veprimet që u ngarkoheshin të akuzuarve. Për më tepër, kjo qasje e Prokurorit të Shtetit përbën edhe një precedent të rrezikshëm në raport me lirinë e mediave dhe gazetarët.

Në një rast tjetër, Prokurori i Shtetit kishte vendosur që të akuzojë një person për pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare me arsyetimin e vetëm se ky i fundit kishte penguar ish-kryetarin e Mitrovicës Agim Bahtiri gjatë përurimit të një shkolle. Mënyra e kryerjes së kësaj vepre, siç theksohet në aktakuzë, është se i akuzuari i kishte marrë gërshërët dhe me to kishte prerë këtë shirit, kinse duke parandaluar Bahtirin që të kryejë detyrën zyrtare.<sup>58</sup> Ky përkrahim i dhënë në aktakuzë qartazi nuk përputhet në asnjë pikë me elementet e veprës penale që i ngarkohej të akuzuarit në këtë rast. Për më tepër, për t'u konsumuar kjo vepër penale, kërkohet që kryesi me forcë apo kanosje serioze, të pengojë apo të tentojë të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke i përdorur këto mjete të njëjta të detyrojë personin zyrtar të kryejë detyrën zyrtare.<sup>59</sup> Pra, në rastin konkret, përurimi i objektit të shkollës është akt simbolik, dhe sipas legjislationit nuk paraqet veprim zyrtar, të cilën kryetari i komunës si person zyrtar do ta ndërmernte në kuadër të autorizimeve të tij të përcaktuara me ligj.<sup>60</sup> Gjykata gjatë këtij viti e kishte hedhur poshtë këtë aktakuzë.<sup>61</sup>

## 9. Gjykatësi “pishmanli”

Më 3 shkurt 2022 gjykatësi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Eroll Gashi, kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj Xhelal Sveçlës, tani Ministër i Punëve të Brendshme, i cili kishte munguar në seancë edhe pse ishte ftuar me rregull. Detajet nga zhvillimi i kësaj seance gjyqësore ishin raportuar nga ana e Betimi për Drejtësi, ku ishin cituar deklaratimet e

<sup>57</sup> “Prokuroria tërhiqet nga aktakuza, pushohet procedura penale ndaj dy të akuzuarve për lajmërim apo kallëzim të rremë”. Betimi për Drejtësi. 22 maj 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-aktakuza-pushohet-procedura-penale-ndaj-dy-te-akuzuarve-per-lajmerim-apo-kallezim-te-rreme/>). (Qasur së fundi më 15.06.2022).

<sup>58</sup> “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari se pengoi ish-kryetarin e Mitrovicës, Agim Bahtirin për të prerë shiritin e përurimit të shkollës së re”. Betimi për Drejtësi. 7 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-se-pengoi-ish-kryetarin-e-mitrovices-agim-bahtirin-per-te-prere-shiritin-e-perurimit-te-shkolles-se-re/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

<sup>59</sup> Kodi NR. 06/L-074 penal i Republikës së Kosovës. Neni 401.1.

<sup>60</sup> Ligji NR. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, neni 58.

<sup>61</sup> “Hudhet poshtë aktakuza ndaj të pandehurit se pengoi ish-kryetarin e Mitrovicës, Agim Bahtirin gjatë përurimit të një shkolle”. Betimi për Drejtësi. 1 maj 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-te-pandehurit-se-pengoi-ish-kryetarin-e-mitrovices-agim-bahtirin-gjate-perurimit-te-nje-shkolle/>). (Qasur për herë të fundit më 15.06.2022).

gjykatësit Gashi.<sup>62</sup> Pas këtij raportimi, gjykatësi i rastit ishte prononcuar në një media online duke mohuar lëshimin e kësaj urdhërese.

Më pas, ka qenë GjTh në Prishtinë e cila përmes një reagimi kishte mohuar lëshimin e kësaj urdhërese ndaj ministrit Sveçla.<sup>63</sup>

Krahasuar me procesverbalin zyrtar dhe audiincizmin e publikuar nga “Betimi për Drejtësi”, rezulton se deklarimi i gjykatësit Gashi dhe kjo komunikatë e gjykatës kanë përmbajtur të pavërteta.<sup>64</sup> Në seancë gjyqësore, në asnjë rast nuk është thënë se urdhëresa për sjellje me detyrim do të lëshohet vetëm nëse të pandehurit nuk paraqiten në seancën e radhës, por kjo është thënë vetëm në deklaratimet e gjykatësit Gashi, të publikuara në media online.

Procesverbali përbën dokument zyrtar dhe vendimet e karakterit procedural, siç ka qenë lëshimi i urdhëresës për sjellje me detyrim ndaj Sveçlës evidentohen në të dhe ky aktvendim i marrë ka qenë në fuqi, derisa i njëjti të revokohet. Sipas procesverbalit të kësaj seance, ku ishte i akuzuar Xhelal Sveçla dhe të tjerët, i cili është përpiluar nga vetë gjykatësi Eroll Gashi, thuhet se *“Nuk prezanton i pandehuri Xhelal Sfeçla, edhe pse i njëjti është ftuar në mënyrë të rregulltë, mirëpo mungesën e tij nuk e arsyeton”*. Po në këtë procesverbal, gjykatësi Gashi ka konstatuar se: *“Palët të cilat janë ftuar në mënyrë të rregulltë dhe nuk janë prezantuar në seancë, gjykata do të lëshojë urdhëresë për sjellje me detyrim”*.<sup>65</sup>

Situatat e tilla kur i akuzuari i ftuar me rregull nuk paraqitet në seancë janë të rregulluara në mënyrë të qartë me nenin 307 të KPPK-së. Kjo dispozitë ka përcaktuar se gjykatësi i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues do të lëshojë urdhërarrest në rastin kur personi i akuzuar i cili është ftuar me rregull, nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën e tij. Tutje, një dispozitë e tillë parasheh se *“kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë”*. Sipas këtij neni, revokimi i këtij urdhri, bëhet vetëm nëse i pandehuri e arsyeton mungesën para arrestimit të tij. Nëse kjo nuk ndodh, sipas KPRK, urdhri duhet domosdoshmërisht të zbatohet.

Për këtë, është i paqartë reagimi i gjykatësit Gashi dhe gjykatës ku ai vepron, në lidhje me një të vërtetë të pohuar nga goja e këtij gjykatësi në prezencë të publikut në gjykatore dhe të konstatuar në letër, përkatësisht në procesverbal si dhe të dëshmuar përmes provës audio, ku

<sup>62</sup> “Urdhërohet të sjellet me forcë ministri Sveçla në rastin ku së bashku me 12 të tjerë po akuzohet për veprime të dhunshme në protestën e 2013-ës”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/urdherohet-te-sjellet-me-force-ministri-svecla-ne-rastin-ku-se-bashku-me-12-te-tjere-po-akuzohet-per-veprime-te-dhunshme-ne-protesten-e-2013-es/>). (Qasur për herë të fundit më 16.06.2022).

<sup>63</sup> “Gjykata Themelore në Prishtinë thotë se nuk është lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj ministrit Sveçla”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-themelore-ne-prishtine-thote-se-nuk-eshte-leshuar-urdherese-per-sjellje-me-detyrim-ndaj-ministrit-svecla/>). (Qasur për herë të fundit më 16.06.2022).

<sup>64</sup> “Redaksia e “Betimit për Drejtësi” reagon ndaj deklaratës së pavërtetë të gjykatësit Eroll Gashi dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/redaksia-e-betimit-per-drejtesi-reagon-ndaj-deklarates-se-pavertete-te-gjykatesit-eroll-gashi-dhe-gjykates-themelore-ne-prishtine/>). (Qasur për herë të fundit më 16.06.2022).

<sup>65</sup> Procesverbali i seancës gjyqësore të mbajtur më 03.02.2022 në GjTh në Prishtinë në çështjen penale me nr. P.nr.664/14.



dëgjohej në tërësi deklarimi i gjykatësit Gashi, i cili thotë pikërisht atë që është raportuar nga “Betimi për Drejtësi”, që dëshmon të kundërtën e asaj për të cilën ka reaguar.<sup>66</sup> Ndërrimi i qëndrimeve të gjykatësit në fjalë përmes deklaramëve në media, në kundërshtim me të vërtetën, e cila dëshmohej përmes procesverbalit dhe audioincizimit, vë në dyshim kredibilitetin e gjykatës. Kjo është veçanërisht e theksuar kur kemi të bëjmë me raste të figurave të larta publike, siç është rasti me Ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla.

Për këto veprime, ndaj gjykatësit Gashi është iniciuar procedurë disiplinore.

Në anën tjetër, pas të pavërtetave të thëna nga gjyqtari Gashi në lidhje me lëshimin e urdhrit për sjellje të detyrueshme, i cili urdhër, siç u tha, nuk mund të revokohet nëse i pandehuri nuk e arsyeton mungesën para arrestimit të tij, më 6 qershor 2022 është tentuar të mbahet seanca në këtë rast. Kjo seancë ka dështuar, por se në këtë seancë ka prezantuar Ministri Xhelal Sveçla. Gjatë kësaj seance, gjyqtari Eroll Gashi nuk ka treguar nëse i pandehuri ka sjellë arsyetim para arrestimit të tij dhe nëse urdhri është revokuar. Kjo çështje ka kaluar në heshtje. Në fakt, kjo sjellje e gjyqtarit paraqet shkelje të re disiplinore nga ana e tij.

Në këtë mënyrë, gjyqtari Gashi tanimë ka humbur kredibilitetin për trajtimin e këtij rasti. Krahas mbajtjes përgjegjëse për sjelljet e tij, ky rast nuk duhet të trajtohet më nga ky gjyqtar, por rasti duhet t’i ndahet një gjyqtari tjetër, në mënyrë që të mos vihet në dyshim paanësia në trajtimin e këtij rasti.

## 10. Aplikimi "shabllon" i dënimit me kusht

Me rastin e aplikimit të dënimit me kusht, krahas periudhës së verifikimit, brenda së cilës gjykata urdhëron që i dënuari të mos kryej vepër tjetër penale<sup>67</sup>, ndaj të njëjtit mund të caktohen dhe detyrime të tjera për t’u përmbushur brenda kësaj periudhe, siç janë mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor, heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës, të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale, etj.<sup>68</sup>

Për të parë në praktikë se sa gjykatat e DP përfshijnë në dënimet me kusht këto detyrime, IKD ka analizuar 100 aktgjykime dënuese të gjykatave të Republikës së Kosovës, të nxjerra përgjatë tre viteve të fundit për vepra të ndryshme penale që trajtohen në këtë divizion. Nga aktgjykimet e analizuar rrjedh se gjykatat e shkallës së parë në asnjë rast nuk kanë shqiptuar ndonjë detyrim të caktuar në raport me kryesit e veprave penale, krahas dënimit me kusht.

Këto të dhëna flasin për injorim të plotë të detyrimeve që mund të caktohen me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht. Këto detyrime kanë për qëllim kryesor përmirësimin e kryerësit

---

<sup>66</sup> Emisioni Betimi për Drejtësi 266: “Gjykatësi “pishmanli”. Betimi për Drejtësi. 12 shkurt 2022 (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/betimi-per-drejttesi-266-gjykatesi-pishmanli/>). (Qasur për herë të fundit më 16.06.2022).

<sup>67</sup> Kodi nr. 06/1-074 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 48.2.

<sup>68</sup> Po aty, neni 56.

të veprës penale dhe mbrojtjen nga recidivizmi.<sup>69</sup> Kështu, në bazë të gjetjeve të këtij raporti, gjykatat nuk kanë pasur parasysh këto aspekte. Në këtë mënyrë, gjetjet flasin për aplikim “shabllon” të dënimit me kusht nga gjykatat, i cili nuk kombinohet, ashtu siç e mundëson ligji, me urdhëra të tjerë të veçantë

---

<sup>69</sup> Salihu I. Zhitija H. Hasani F. “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës”, 2021, f.228.